



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

## KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Më: 25 shkurt 2026

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 25 shkurt 2026 (e mërkurë) në sallën e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në ora 10:00 minuta.

**Pjesëmarrës nga KPF-ja,** ishin: Simir Krasniqi, Kryesues i KPF-së, Ymran Fusha, Trëndelina Kastrati, Arianit Berisha, Dafina Alishani, Ilir Gashi, Haziz Hodaj, Agnesa Sinanaj Gavazaj dhe Shukri Quni, të gjithë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Pjesëmarrës tjerë ishin:** Levent Bus – Drejtor i Ekonomisë dhe Financave, Islam Ukaj – Drejtor i Shërbimeve Publike, Lulzim Sylejmani nga drejtoria e ekonomisë dhe financave, Arbër Krasniqi – nga zyra e kuvendit të komunës, Gursel Skenderi nga zyra e pronave, Ymer Berisha dhe Haziz Krasniqi nga zyra për komunikim me publikun, Emine Gashi zyrtare ligjore si dhe mediat.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** A fillojmë, a jemi gati? Përshëndetje për të gjithë. Të nderuar anëtarë të komitetit për politikë dhe financa, të nderuar drejtorë, zyrtarë të drejtorive, media dhe ju të pranishëm, Përshëndetje për të gjithë. Ashtu siç jeni njoftuar me kohë, sot e kemi thirrur mbledhjen e dytë të komitetit për politikë dhe financa për vitin 2026. Prezent jemi nëntë anëtarë të komitetit për politikë dhe financa dhe mund të vazhdojmë me këtë mbledhje. Për këtë mbledhje kemi propozuar këto pika të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme të KPF-së, të datës 23 janar 2026;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit paraprak të listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit të Ankesave;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për zgjedhjen dhe delegimin e përfaqësuesve nga Ekzekutivi dhe Kuvendi i Komunës në Asociacionin e Komunave të Kosovës;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale KRM “Eko-Regjioni” Sh.A. Prizren;

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A – Prizren;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit dhe iniciimin e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të tij;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit ad hoc për organizimin e procesit të zgjedhjes së tre (3) anëtarëve të Këshillit të Fshatit Zym i Hasit;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit të veprimit për transparencë 2026-2030;
12. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës janar-dhjetor 2025;
13. Raporti financiar vjetor janar-dhjetor 2025;
14. Diskutim rreth raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prizrenit për vitin 2024 dhe planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2024;
15. Informatë rreth raportit për planin e Integritetit për vitin 2025;
16. Informatë rreth raportit të performancës për Komunën e Prizrenit për vitin 2024.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Konstatojmë që kemi kuorum, nëntë anëtarë jemi të komitetit për politikë dhe financa.... Po. kështu pasi që e dini të gjithë që ka pas, ka qenë vit zgjedhor pra edhe prej korrikut nuk ka pas seanca. Edhe janë grumbulluar pikat që po në kuvend ne deri kur ju e shihni të arsyeshme që mund të e kryejmë deri në pikën e tetë, të nëntë, vazhdojmë deri aty me marrëveshje të nesërmen në ora 10:00 e vazhdojmë pikën e dhjetë, njëmbëdhjetë. Po, Dafin.

**Dafina Alishani:** Kështu, kam frikën që nëse zgjat dy ditë, atëherë këto pika të cilat nuk kanë nevojë me votu kanë me pas asnjë interesim dhe në mbledhjen e dytë nuk vijnë asambleistët. Nëse duam me pas secilën pikë me e diskutuar ashtu siç ka hije, atëherë duhet me ndryshu edhe renditjen e pikave, në mënyrë që me pas domethënë diskutim edhe të tjera raporte, sepse ju e dini shumë mirë raportet pak a shumë bëhen vetëm për me marrë një pikë të draftit të performancës. Nuk është që ka interesim fort as kryetari e as zyrtarët me diskutu siç është siç ka hije brenda kuvendit. Unë propozoj ashtu ashtu unë e po ma merr mendja që kjo domethënë këto pika kanë me zgjat dy ditë. Nëse zgjat dy ditë, atëherë unë propozoj që renditjen pak me e ndryshu që në mënyrë me pas një farë balance për dy ditë, mos me qenë një ditë vetëm raporte, sepse edhe mos me ardh kuvendarët, ato vetëm kanë me raportu kot. Domethënë veç kanë me marrë pikën edhe s'kanë me pas efekt kurrgjë. Edhe edhe një çështje të fundit, në herën e fundit kur u mbledhëm shefat e grupeve, ju lutëm me pas hapësirë mes KPF-së edhe seancës. U lutëm edhe të premtën mos me mbajt seancën, por kjo domethënë edhe kaq shumë pika, secili grup mendoj edhe besoj që mbas KPF-së ka takimin që me u parapri domethënë diskutimeve dhe bashkë me grupin. Është shumë kohë e shkurtër mes KPF-së edhe kuvendit. kështu ju kisha lut që herat e tjera me pas kujdes së paku nja dy ose tre ditë me pas hapësirë mes KPF-së edhe seancës.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit Dafina.

**Agnesa Sinanaj Gavazaj:** Nëse bëhet puna se unë me fol, a unë po pajtohem me Dafinën se shumica e pikave janë pika të formimit të komisioneve që paraprakisht është mirë me e votu që

kush shkon me shkuar veç çka me bërë edhe mos zgjasim shumë. Edhe nëse kursehemi pak a shumë prej asambleistëve me tendenca politike, mendoj që kryhet më shpejt. Secili asambleist me e kursu veten me fol atëherë një herë edhe po na humb koha, çdo herë po na merr shumë kohë. Kështu që me marrë më seriozisht edhe me e kry më shpejt. Që mos me pas nevojë me marrë dy ditë.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Urdhëro.

**Shukri Quni:** Duhet që në fillim me fillu me fillu për nesër thashë unë kam fol mirë Dafina dhe unë të dy e dimë pjesën. Ne kolegët e komitetit për politikë dhe financa e kemi ditë këtë punë. Ne jemi zgjedhur nga populli dhe votat e popullit. Edhe jemi para atyre me mbrojt të drejtat e qytetarëve. Sa do që zgjat mbledhja, ne do të jemi këtu. Plus po jap nga ato pikat më të rëndësishme që janë në fund. Kurr gjë nuk na ndalon neve me e mbajt edhe kaq shumë mbledhje, nga se po e shoh nevojën edhe prej nga ana jonë. Për atë jemi këtu se s'kemi nga të tjerë si asambleistë me e ligjërë tjetër në atë tjetër punë s'kemi, që kjo është mbledhja jonë është primare. Zyrtarisht, privatisht mund me fol çdo gjë, zyrtarisht e dimë, këto e kemi fol. Edhe kështu që të gjithë ne po e dimë që unë kam qenë vetë në opozitën e juaj edhe e kemi bërë opozitë një farë opozite të fortë, falë asaj opozite që sot jeni në opozitë. Që po e dimë çka po ndodh. S'po e dimë çka po ndodh. Po i japim ëh sugjerime ne po i japim more kolegë. Unë nuk e di për çka po mbledhemi kaq shumë kohë. Edhe plus votat i keni. Unë e di që me e propozu po është këtu a për shkurt me e shkurtu rendin e ditës, shkurt me e shkurtu ne jemi para atyre që na kanë votu politikisht. Nëse dojmë që s'duhet me e votu politikisht, e votojmë politikisht. Unë e kam shumë arsye, secili tash mund me e marrë me e analizu që që kjo renditje është mirë me u shkurtu, me e mbajt edhe një ditë. Secili do raport të ketë, raport të punës, të cilat duhet ëh me e marrë me e marrë fjalën edhe me dhënë vërejtje edhe lavdërime po po e shoh me dhënë vërejtje edhe lavdërime. Pastaj është raporti financiar vjetor vjetor janar-dhjetor 2025. Këto që janë këto farë komisione të auditimit që po shkojmë shkurt, janë ato gjëra që kanë një gjë dhënë votat që shumë kohë domethënë kjo mbledhje po na merr dhe këto mbledhje kaq shumë kohë. Edhe me pas hapësirë të duhur. ëh për këto vota për shkurt.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit. Është çështja e kohës edhe neve disa raporte duhet t'i kryejmë, mos të zgjasim edhe jemi të obliguar që në këtë seancë të kryhen. Edhe shumë mirë e tha Agnesa dhe unë e thashë ne mundëm edhe një ditë të premtën kurr gjë mos po po s'ka mos me ardh tash. Asnjëri nuk e kemi se dhe ligji për pagat po na lejon tash me pas një punë sekondare që jemi të angazhuar me një punë tjetër. Do të thotë të gjithë kuvendorët janë kur të vijnë në seanca edhe në qoftë se dhe ai vazhdimi janë të obliguar që me ardhur edhe s'ka çka mos me qenë serioze vazhdimi i mbledhjes edhe mos prezenca e tyre kuvendorëve. E vazhdojmë të nesërmen në ora 10:00 edhe nuk ka se çka. Deri kur ju mendoni që deri në pikën e tetë, nëntë, këto kryesues jemi lodhur, nuk mundemi me vazhdu, arsyeja që është ramazan, vazhdojmë të nesërmen në ora 10:00 edhe i kryejmë të gjitha pikat, që janë disa pika duhet t'i kryejmë patjetër.

**Dafina Alishani:** A ban veç diçka?

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Urdhëro.

**Dafina Alishani:** Kërkush nuk e përmendi as ramazanin as...

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Ani unë e thashë për çka unë unë e thashë, ndoshta ata nuk e përmendët ju, unë e thashë Dafin që është lodhje.

**Dafina Alishani:** Ideja kësaj është kështu, domethënë përveç raporteve financiare ne e kemi edhe këtu raportin e zyrës së auditimit që ka shumë rekomandime të cilat duhet me i diskutu. Edhe a ban me propozu domethënë këto edhe unë po e them prap renditjen nëse e ndërrojmë, në rregull jemi. Shkaku që prap po them, ditën e dytë ka me pas prezencë të zbehtë edhe nuk ka me pas diskutime që duhet me pas te këto raporte të cilat janë ketu.

**Agnesa Sinanaj Gavazaj:** Pikërishtë për këtë po them edhe unë, me i shmang debatet dhe fjalët përsëritura të asambleistëve nga një tjetri, edhe me i gra më shpejt.

**Dafina Alishani:** Nuk mundesh me e ja determinu ti asambleistët çka flet ose çka përfaqëson se secili asambleist secili asambleist brenda një muaji...

**Agnesa Sinanaj Gavazaj:** Kurgja nuk i gjen nese nuk bëjnë një ditë politikë edhe na kursejnë edhe na me kry më shpejt.

**Dafina Alishani:** Po ne përfaqësues politikë, qysh mos me bërë politikë?

**Agnesa Sinanaj Gavazaj:** Po bën sa dush por mos te përsëritën senet se ne të gjithë e dimë se secili prej juve për shembull secili prej juve e merrni fjalën e i thoni fjalët e njëjta.

**Dafina Alishani:** Rregull është po ju e determinoni a ne dojmë, secili asambleist e ka të drejtën e fjalës.

**Agnesa Sinanaj Gavazaj:** E kena fjalën për me kry punë më shpejt, pasi është situata me 16 pika se për mu deri mbas ditës edhe me kryu s'është problem.

**Dafina Alishani:** Po ne kemi kërkesa të cilat ne i mbledhim brenda një muaji prej secilit qytetar që i kontaktojmë. Secili prej juve e ka fjalën...

**Agnesa Sinanaj Gavazaj:** Po mos përsëritni se ne e dimë se çka është më shpejt pika.

**Dafina Alishani:** S'mundemi asnjë asambleisti me ja determinu çka flet, po më vjen keq, une smuj.

**Haziz Hodaj:** Më fal kryesues, faleminderit. Përshëndetje për për të gjithë. Se nuk është fjala me ja determinu as me ja me ja imponu. Po, është e vërtetë që janë grumbulluar pikat e rendit të ditës sepse ka afate ligjore që duhet me i kry. Po kjo me e mbajt mbledhjen për dy ditë në pamundësi me e kry në ditën e parë e vazhdojmë të dytën, që dhe të dytën është ajo freskia prap se zgjohemi në mëngjes inshallah shëndoshë e mirë edhe prap vijmë edhe ata që janë të interesuar me diskutu edhe me i elaboru pikat e rendit të ditës ata nuk mungojnë sigurisht. Kështu që nuk nuk prish punë,

le të shkojë a ëh që ky rend i ditës po le të mbetet gjysma e pikave të rendit të ditës apo më pak, mundësisht më pak është mirë me mbet për ditën e premtë edhe vazhdojmë, kështu që nuk nuk ka ndonjë problem. Ata që janë të të të interesuar me diskutu me me elaboru mirë secilën pikë të rendit të ditës ata nuk mungojnë në mbledhje. Mos u brengos për at punë hiç.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit. Po Shukri Quni.

**Shukri Quni:** Këto janë pika të cilat nuk, si tha edhe Hazizi, nuk ka nguti për këto, këto raporte. Nuk jam me vazhdu mbledhjen ditën tjetër, po jam me i heq disa pika edhe me i caktu në mbledhjen tjetër. S'ka nevojë me e zgjat mbledhjen dy ditë. Unë jam kundër asaj. Unë jam me u reduktu Agnesë rendi i ditës 16 pika, janë disa pika që i mundemi me i heq që nuk i kalojnë afatet. A këto që i kemi me i votu këto komisione edhe që janë me rëndësi këto nuk janë me i heq. Edhe në 10 shkojnë, edhe në 12 s'është problem. Po janë disa që duhet me i heq që me i diskutu ne më tepër, jo me shku shkel e shko. Raporti i punës duhet me qenë në pikën e tretë. Që po thotë kështu, në raporte mund me qenë në si të kryhet domethënë çështja që i ngritin kuvendorët, ne duhet me fillu menjëherë me me raporte që kanë me raportu kushdoqoftë, auditimi apo kryetari, çka do të jetë. Se sa po e komisione votat i keni, hiq a edhe me dalë unë jashtë ty ato i kalon, hiq so problem.

**Agnesa Sinanaj Gavazaj:** Po këto po kam me dhënë që kështu shkon shpejt tani nesër në shkurt.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit. Po. Po edhe Iliri edhe po vazhdojmë.

**Ilir Gashi:** Atëherë nëse ka mundësi pra këto pika që janë raportuese, nëse ka mundësi me i debatu t'i vendosim në fillim, të tjerat i vendosim mbas tyre edhe shkojmë më shpejt atëherë nuk ka kërkush. Edhe një pikë tjetër pika e tretë ëh, a e keni parë a është ligjore me e pas në rendin e ditës, sepse ligji edhe rregullorja e qeverisë për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale është shumë e qartë se deri më 31 dhjetor duhet të miratohet lista e përgjithshme dhe e veçantë e pronave që do të jepen në shfrytëzim. Afatin e kemi kaluar më 31 dhjetor.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** E kemi zyrtarin e pronave këtu, kur të dalim në atë pikë e ndalim edhe diskutojmë në detaje. Faleminderit.

**Ilir Gashi:** Jo po kam fjalën si pikë të rendit të ditës.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Është zyrtari, këtu kemi lyp sqarime, ai e jep përgjigjen, e jo tash mos të dalim prej pikave e kur të vjen te pika e rendit të ditës ndalojm aty.

### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme të KPF-së, të datës 23 janar 2026;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Atëherë se tash shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme të komitetit për politikë dhe financa të datës 23 janar 2026. Ka dikush me shtu rreth procesverbalit? Atëherë që nuk ka me shtu e hedhim në votim. Unanimisht votohet procesverbali.

## **2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Ne edhe pse paraprakisht hyjmë te rendi i ditës do të thotë gati u konsumuan pra bisedat e rendit të ditës, e hedhim në votim edhe rendin e ditës. Kush është për? Gjashtë për. Kundër? Tre kundër. Pra kalon rendi i ditës.

## **3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit paraprak të listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Kemi përfaqësuesin e pronës këtu dhe ja japim fjalën zoti Gursel Skenderi.

**Gursel Skenderi:** Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Është obligim ligjor që komuna për çdo fund vit të miratojë listën e pronave komunale, por për shkak të zgjedhjeve lokale afati për miratim nga asambltetë komunale që është shtyrë kët vit po të vijë edhe si pas shkurtimit të mbledhjes. Domethënë është deri po është shtyrë për shkak të zgjedhjeve edhe para katër viteve ka qenë edhe këtë vit. Domethënë kur kemi zgjedhje lokale gjithmonë shtyhet ëh kjo, nuk është afat deri më 31 dhjetor. Lista e pronave komunale është e njëjtë me vitet e kaluara, ju e dini shumica është me disa ndryshime dhe disa rifreskime që i kemi vërejtur nga ana e drejtorive të ndryshme. Prandaj për arsye se është obligim ligjor i çdo komune, kjo pikë unë kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të procedohet për asamble komunale. Faleminderit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit. Ka dikush që don me marrë fjalën?

**Dafina Alishani:** Mfal zotëri Gursel, a mundem me ditë se ku është fletë njoftimi i MAPL-së.

**Gursel Skenderi:** Po, fletë njoftimin po është e po e kemi edhe kryesuesi edhe kryetari edhe na mundemi Dafina me ja bashkëngjit atë njoftim.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Në kuvend ja sjellim.

**Dafina Alishani:** A ban tash, kam disa pyetje, për zyrtarin? nën një a mundemi me pas një listë të pronave të cilat janë të uzurpuara? Secili vitë domethënë kur vjen lista për prona, a duhet me pas edhe një listë me ditë ku i kemi pronat e uzurpuara apo jo? Nën dy, a ka lokale të komunës që janë pa kontratë? Nëse po, pse ende vazhdojnë me qëndru aty? Edhe kush është përgjegjësi për këto lokale, sepse kemi pas edhe ankand, kemi pas edhe thirrje, kemi pas edhe përzgjedhje edhe në fund nuk ka as pagesë të qirasë, as përgjegjës për këtë punë edhe vazhdojnë me qëndru në lokalet komunale, ndërsa bizneset e tjera këtu mundohen me mbijetu me qira të larta, sepse nuk e kanë pas dikë në komision për me marrë një lokal komunal. Edhe e dyta, janë disa lokale që janë të lëna mbas dore. Për shembull te Qafa e Kishës në qoshe që ka qenë libraria syprint ajo është shumë për fat keq që është qashtu. A ka komuna plan me investu aty? Ju si zyrë e pronave a keni dërgu tek

drejtoritë përkatëse për gjendjen e këtyre lokaleve apo për ju është me rëndësi vetëm lista e mandej pazaret e dhënies i bën dikush tjetër. Pa pas listë të uzurpimeve dhe pa pas aksione të inspektoriatit këto listat që votohen unë nuk e di kujt i shërbejnë. Edhe e fundit në pronën e cila është dhënë që keni bërë komisione poshtë të tregut, a ka pasur ndonjë raport të atij komisionit tek zyra e pronave edhe a janë duke shkuar me planin e biznesit ashtu qysh i kanë marrë pronat? Sepse aty është një pronë tepër e madhe një qira aty këtu solide por plani i biznesit me investimet edhe me veprimtari nuk kërkon hiç. Faleminderit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit, fjala për ju.

**Gursel Skenderi:** S'është pikë e rendit të ditës kjo, është lista e uzurpatorëve, pyetja e parë. Lista e domethënë i kemi në listën e uzurpatorëve? Sektori i pronës nuk din vendngjarje. Uzurpime nëse bëhen nga ato ne na njoftojnë qytetarët edhe edhe inspektorati.

**Dafina Alishani:** Më fal, sektori i pronës, a e keni përgjegjës për pronën? Jo, jo, jo.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Dafina, mundësisht kur ta jepë përgjigjen ta dëgjoni.

**Dafina Alishani:** A jeni përgjegjës për pronën, ju e dini pronat e juaja, qysh? Ani, a i raportoni? Unë po dua me ditë pronat e uzurpuara, a jeni të vetëdijshëm?

**Gursel Skenderi:** Lista çka kemi, çka kemi udhëhequr procedurat të gjitha janë në lista. Për procedurat çka kemi udhëhequr.

**Dafina Alishani:** A janë këtu qato lista?

**Gursel Skenderi:** Jo, nuk hyjnë këtu në Dafin. Unë pse thashë e ke përzier atë çka si me nuk është term i uzurpatorëve. E dyta, lokalet pa kontratë. Lokal pa kontratë nuk ka vetëm janë pesë e ish e domethënë e di Iliri që s'ka pasë e si overtues, janë pesë lokalet këtu në te ëh çka po thona këtu në Bazhdarhone, është edhe lokali çka e cekët ju te Qafa e Kishës. E riparimi i lokaleve te Qafa e Kishës, unë e kam cekur në mbledhjen e drejtorëve, drejtorit çka është në po sipas drejtorit të administratës ka qenë domethënë mjetet ato qysh janë bërë ato procedura, si të shfrytëzohen mjetet, si të zgjidhen ato jo, ka mu riparue. Bile këtë çështje e ka çështje e ka e ka ngritur që të edhe e ngritur në Asamble. A po jo? Edhe unë e, po të dëgjoj. Po, e ka ngritur edhe Iliri e kam ngritur në Asamble që kur e sipër e ngrita. E pyetja katërt qenë ishte raporti i komisionit. Edhe unë e raportin e komisionit po ishte informuar komisioni vitin e kaluar. Domethënë edhe ka dalë prej pesë anëtarëve, prej të gjitha drejtorive e ka raportuar kryetari në mbledhje. Lus, Lus, Dafin edhe pse s'është pikë e rendit të ditës kjo, po u formua prapë komisioni që tashmë me afat katër vjeçar çka po shkon. Po sipas ligjit po çdo gjashtë muaj ky komisioni e raporton kryetarin, por në dy raste edhe kryetari është i obliguar po sipas nenit 22 të ligjit domethënë me me raportuar me raportin e punës për investimet ato që kanë bërë këtu për katër vjetësh plan të investimeve. Po komisioni është ka qenë i formuar plus që tash u formua për katër vjetësh ëh është prej pesë, pesë vetë në drejtoritë. Faleminderit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit, fjala për ju Shukri Quni.

**Shukri Quni:** Deshta me ditë këto pronat a janë të gjitha në këtë listë apo ka ende prona tjera.

**Gursel Skenderi:** E kjo është qysh thashë për zoti Shukri, unë e thashë në edhe në njoftimin domethënë e kemi ri freskuar. Nuk mundim me thënë çka janë të gjitha, arsye, arsye është për shkak të emërtimeve të ndryshme ju e dini çka në në Asamblenë e kaluar e kemi e kemi votuar një vendim për ndryshimin dhe plotësimin për atributet e pronave dhe regjistrimin e tyre në si pikë në emërtimin Komuna e Prizrenit. Mirëpo, mirëpo nuk na ka ardhur ligjshmëria, kemi pasë, kemi pasë pengesa faktikisht më së shumt,i më së shumti prej Ministrisë së Infrastrukturës. Kemi dhënë një takim të gjithë i kemi shkruar jemi të gatshëm me e marrë. Për shkak se ka mbi 20 emërtime të ndryshme domethënë edhe në gjuhën shqipe rrugë, udhe ,vi rrugë pa kategorizim me kategorizim e te mirat e fshatit Dobrasellë edhe domethënë ka të ndryshme, ashtu ne nuk mundim me thënë çka është asi,po për qdo vit prej drejtorive e rifreskojmë.

**Shukri Quni:** Edhe qekjo në fshatra po më intereson, kto pronat nga fshatrat që janë, listën që e kemi përpara janë të gjitha prona të komunës.

**Gursel Skenderi:** Është obligi ligjor me e votue listën, qetash nëse kryetari vendos me dhane ndonjë pronë dikuj mas disa muajve pesë-gjashtë muaje ajo lista duhet me qenë nqet listë, nëse nuk është MAPL-ja i kthen në joligjshëm. Domethënë duhet me qenë nqet listë. Pse i thuhet vendim paraprak, nuk është patjetër pse është patjetër me e shpallë tender po në listë nese vijm.

**Shukri Quni:** Po flas për fshatra, për qasjen e fshatrave jo këto të qytetit.

**Gursel Skenderi:** Njejt janë, njejt janë, ska dallim fshat apo qytet.

**Shukri Quni:** Edhe nëpër fshatra ka prona të komunës që shfrztëyohen prej njerzve, e ka ba zotnia edhe si intereson, a ka munds i kjo me i nxerr pronat e veta, a e din sa pronat janë. Ka edhe njerz që kanë maru shpia, e na per qeta jemi tu i ygjidh kto probleme. Se pse po tham une tash, tash dikush po merr e dikush jo, kur tja ngjesish mos u muno dikun nëse është npytje tant me marr kapak. Do gjana nuk jeni nrrjedha ju përshembull sidomos gjinija femërore nuk ka qasje ktu, por na që i dimë do sene dikush i ka gra, normal edhe shpijat i kanë ba në prona të komunës.Me numër të kadastrës, me vend e me tgjitha, ja duhet me u ba për tgjithë nane e jo per dikan nane e dikan njerk.Masi kemi ardhur këtu me mbrojtë qatë interesin e qytetarëve. Këtu është ajo edhe a ka të drejtë shembull thashë që unë po thamë Shukri Quni me bërë një kërkesë edhe me e marrë x pronën në shfrytëzim prej komunës. Sikur që po i marrin lokalet tani në Prizren.

**Gursel Skenderi:** Jo, nuk domethënë edhe nëse është shtëpia jote edhe ke pronë komunale përpara nuk ka të drejtë, vetëm nëse domethënë më pak se një vit që është e rregullorja për çështje pronësore. Domethënë nëse e ndërton një shtëpi ose një pronë e me kultivosh pemë e perime me marrëveshje një vjeqare aty. Po nëse kërkosh qysh thotë ligji deri në 15 vjetë nuk ka të drejtë veç me shkuar për sipas procedurave të ankandit atje andej përmes përmes vendimit të Komunës.

Procedurat, raportet do të thotë e ka është i interesuar për këtë çështje sipas hartës zonale nuk parashikohet brenda atyre viteve diçka çka ka ndodhur aty dhe me shkuar atje rrugë e japim me tender atehere zhvillohen procedurat për këtë çështje.

**Dafina Alishani:** Më falni, a mundem unë të bëj një pyetje?

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Urdhero Dafinë?

**Dafina Alishani:** Nese ska kolegë, se un fola një herë.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Vetëm a e përfundove?

**Shukri Quni:** E kreuva.

**Dafina Alishani:** Zona ekonomike a parashihet si pronë komunale? Edhe nëse po, a është këtu meqë kemi pasë shumë premtime që kryhet mandatin e kaluar hajde me inshallah po kryhet në këtë mandat e mos po na thoni mandej i kemi harruar me i futur në listën e pronave, s'kemi të drejtë me i futur.

**Gursel Skenderi:** Po jo keni të drejtën, e keni të drejtën edhe domethënë e do ta bëjmë jo domethënë në rast se katastrofat e zonës ekonomike janë këtu ne aty në nëpër lista poseduese Dafinë shkruhen. Domethënë e Qeveria e Kosovës shfrytëzues ka pasë Komuna e Prizrenit. Po qysh thatë ju i kemi futur në listë, janë në atë listë.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Po faleminderit. Drejtori Islam e ka fjalën.

**Islam Ukimeri:** Ka shumë të drejtë Dafina për aspektin e pronave dhe ndikimin edhe ato pronat brenda zonës urbane nëqoftëse nuk kanë kompetenca të Komunës për shfrytëzimin apo pronës, më mirë me njoftuar Inspektoratin që tha duhet me bërë identifikimin e këtyre pronave brenda zonës urbane dhe cilat prona nuk janë me kontratë apo pa kontratë, qoftë pronë apo lokal. Të marr një rast konkret, para disa ditë unë e kam pasë një kërkesë një kërkesë prej një qytetari që ai nuk po e kishte me lejen e Drejtorisë së Urbanizimit dhe në një nga prej kushteve ka qenë edhe qasja në rrugë. Po ka ardhur me kërkuar qasje në rrugë me lëshuar një qasje në një pëlqim. E kam parë që për me dalë në rrugë duhet me shkelë nëpër pronën e Komunës. Edhe unë i kam thënë qytetarit e një terren dhe po e kam parë një njeri duke shitë dru aty. Kush je ti be zoti? E kujna është kjo pronë? Unë e kam këtë pronë, thotë unë e kam këtë pronë me qira. Ky është qiraxhija, thotë qiraxhija s'është i anonim. Domethënë që është mirë me kërkuar se është ne interes të të gjithve me kërkë identifikimin mbas këtyre pronave tona edhe ato prona që janë të uzurpuara me njoftuar Inspektoratin me i zhvilluar procedurat. Edhe kemi mundësi shumë lehtë edhe me i rregulluar ato prona.

**Dafina Alishani:** E njëjta po ndodh me parkingjet. Malik Impeksi te tregu i gjelbërt mbrapa Abi Centër është tu marrë pare prej qztetarëve e ka qitur rampën. Unë e di që ka masë gjykatës aty edhe që po Inspektorati po ju duheni me treguar pronat.

**Islam Ukimeri:** Jo Dafin, nuk është ajo..

**Dafina Alishani:** Mandej mbrapa Entit për Punësim, edhe aty hapësirë publike aty merret parë për parking. Mandej këto shënjizimet që i keni bërë rrugëve tash domethënë në mandatin e kaluar janë vendosur disa tabela që ka me pasë parking ëh në lagje. Ato a janë të parapara me se ajo ka me u dhënë shfrytëzim. A e di mos po bëjmë se kemi shumë prona të cilat edhe diçka, ne këtu çkado që shohim listë nuk e dimë me numra katastrale domethënë ne veç formalisht kemi me votuar se s'i dimë ku janë. Po ju e keni qatë detyrë, ju zyra e pronave nëse ju nuk bashkëpunoni me Inspektoratin mos pritni qytetari i thjeshtë tash me me bërë punën e juaj. Ju i dini shumë mirë pronat edhe prapë e them ki pronë të cilën e ka fituar tenderin edhe nuk është duke paguar qira, e dinë shumë mirë. Veç pse ka tenderuar shumë shtrenjtë edhe tash s'i del hesapi. Inshallah është, inshallah jam gabim.

**Gursel Skenderi:** Dafinë se qe disa herë janë në media para të gjithëve. Nëse një lokal një lokal është duke u shfrytëzuar edhe nuk ka kontratë, të lutem, të lutem mos e përmend shko atje poshtë. Po. E të gjitha lokalet me numër të kontratës, emrin e mbiemrin, adresën, sa është pagesa mujore i keni në në ëeb faqen e Komunës. E keni obligimin ligjor qysh e kemi qetë listën Dafin, mbasi të votohet, mbasi të votohet, ne kur e kemi konfirmimin prej ligjshmërisë, ne jemi detyruar me e me e me e shpallur në ëeb faqe.

**Dafina Alishani:** Edhe tregu i Qylhanit a është në listë? Edhe kush e menaxhon tregun, a është pronë komunale?

**Gursel Skenderi:** Jo, nuk është.

**Dafina Alishani:** Qysh s'është?

**Gursel Skenderi:** S'është pronë komunale.

**Dafina Alishani:** Okej, në rregull.Na spo dishim kurrjë .

**Gursel Skenderi:** Jo, jo, jo, po de po, është momentalisht në proces gjyqësor, është në proces katastral, nuk është në momentin e tanishëm.

**Dafina Alishani:** A është prona pronë komunale?

**Gursel Skenderi:**Unë me sa kam informacion, jo.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** A kemi diskutime tjera? Faleminderit zoti Gursel. Që nuk kemi diskutime tjera, e hedhim në votim që t'i rekomandohet Kuvendit kjo pikë e rendit të ditës. Kush është për? 7 për. Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 abstenim. Pra, kjo pikë i rekomandohet Kuvendit. Kalojmë te pika e katërt.

#### **4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit të Ankesave;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Edhe këtu fjala për ju.

**Gursel Skenderi:** Po, faleminderit. Po ashtu edhe kjo pikë e rendit të ditës është formimi i komisionit është obligim ligjor të cilin ne duhet e të e votojmë. Pasiqë ky komision shqyrton ankesat të cilat ato që kanë të bëjnë me zhvillimin e ankandëve për dhënien e pronës komunale nëse mbahen ankandet. Si e keni parë edhe mbas propozimit për dhënien e këtij me komisioni është prej pesë anëtarëve, dy kuvendarëve, dy të ekzekutivit dhe një prej OJQ-se. Afati i këtij komisioni sipas ligjit është dyvjeçar. Faleminderit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit. A ka dikush ndonjë pyetje? Atëherë që nuk ka, e hedhim në votim. Sa jeni për që kjo pikë t'i rekomandohet Kuvendit? Unanimisht, pra nëntë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa janë që kjo pikë t'i rekomandohet Kuvendit në mbledhjen që do të mbahet më 26-të pra nesër.

##### **5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për zgjedhjen dhe delegimin e përfaqësuesve nga Ekzekutivi dhe Kuvendi i Komunës në Asociacionin e Komunave të Kosovës;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Vazhdojmë me pikën e radhës. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për zgjedhjen dhe delegimin e përfaqësuesve nga ekzekutivi dhe Kuvendin e Komunës në Asociacionin e Komunave të Kosovës. Këtu materialin e keni marrë. Në bazë të kërkesës pra që është kërkuar Asociacioni ka kërkuar që nbazë të numrit të kuvendorëve që janë të përfaqësuara në Kuvend, Partia Demokratike kryetari pra dhe Partia Demokratike ka dy, LDK-ja e ka një edhe Lëvizja Vetëvendosje e ka një anëtar. Ne e kemi mbajtur një takim pra me shefat e grupeve dhe ju thashë që këtu është mirë që të respektohet edhe kuota gjinore. Pra për emrat e për këta në Kuvend pra sjellën emrat që keni diçka me pyetë rreth kësaj pike. Urdhno Shukri Quni, fjala për ty.

**Shukri Quni:** Edhe atë ditë e diskuaam qysh thashë nëse rregullohet domethënë çdo i dhjeti kuvendor shkon nga një, neve si na takojnë katër. Edhe kryetari i pestë. Po tash kjo ndarja këtu për shembull tash këto dy shkojnë te PDK-së edhe kryetari tre, një shkon i Vetëvendosjes edhe një shkon i LDK-së. S'po e shoh unë PDK-ja të ketë më shumë se dy.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Qashtu është qelsi.

**Arianit Berisha:** Pak është. Sa kemi qef na pak është.

**Shukri Quni:** Jeni tu hupë, qetu është problemi, se ata që mundohen me marrë shumë ato humbni krejt. Po ku je ulur ti qaty jam kanë unë?

**Arianit Berisha:** Veç ndershëm duhet me marrë se unë mendoj.

**Shukri Quni:** Jo, jo, jo. Sa të mundesh ndershëm mundesh. Ndershëm mundesh kryetari edhe një kuvendor i PDK-së edhe me marrë një nga Vetëvendosja, një nga LDK-ja, një nga Bashkimi Demokrat. Kjo është e ndershme. Në politikë.

**Arianit Berisha:** Në bazë të çka i mendon këto ato çka?

**Shukri Quni:** Në bazë të partive, jemi edhe ne komision.

**Arianit Berisha:** Po është është një formulë aty.

**Shukri Quni:** Pse se keni marrë edhe këta edhe tonen.

**Arianit Berisha:** Po e kishim marrë, po tash është ligj është një formulë që i shpërndan këto katër në bazë të ulëseve që janë në Kuvend.

**Shukri Quni:** Në bazë të ulëseve ka një anëtar i takon të gjithëve. Mbas ulëseve po thotë katër ëh nga Kuvendi një nga Kuvendi i dytë, një nga Kuvendi i tretë, një nga Kuvendi i katërt. Domethënë katër shkojnë në Kuvend edhe kryetari shkon i pestë. Tash ju PDK-ja dy.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Po është çelësi.

**Shukri Quni:** Plus kryetari tre.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Çelësi është që po ja jepni fuqi në këtë çështje. A do e bëjmë pazar? Mirë, këtë ndarje nuk e kemi bërë ne, e kanë bërë përfaqësuesit e Asociacionit që e kanë prurë ata në një nivel të Kosovës. Jo, nuk i kemi bërë do të thotë ata vetëm e kanë treguar çelësin që çdo dhjet anëtarë nga një. Këto ne jemi 13 kuvendorë edhe çelësi është ai që na takojnë dy kuvendorë edhe kryetari tre. Po. Tash ëh me pasë mundësi kishna propozuar edhe juve të..

**Dafina Alishani:** Ka pasë mundësi qysh jo. Leventin e ke pasë përfaqësues të PDK-së këtu vitin e kaluar. Bëhuni pak gjenerozë edhe me bacin Shukri.

**Shukri Quni:** Po unë s'e kam me atë punë.

**Arianit Berisha:** Edhe nuk pranohet jashtë rregullave të PDK-së se kishim folë për këtë punë.

**Shukri Quni:** Me ta shkruar i pranoje si mundesh.

**Arianit Berisha:** Si përfaqësues i PDK-së.

**Shukri Quni:** Jo, jo, jo, jo shkruaj. Ti mua nuk nuk më ke pranuar në qeverisjen e kaluar. Këto të jemi të qartë të gjithë. Unë ta kum mbajtur katër vjet, ta kum mbajtur Kuvendin. Me qatë koalicion pak qe ka. Qata Kunvendarë ti sem ki dashtë, tash unë me zorë sun vi me të lutë. Unë e kërkoj të drejtën time, kërkoj që në këtë komision me qenë edhe një i Bashkimit Demokrat. Se tre i keni bollë, s'ka se ne mundemi me i marrë edhe krejt po s'e bëjmë këtë.

**Trëndelina Kastrati:** Nashta nesër ndrojmë.

**Shukri Quni:** Kush? Se shumë kushi i han fjalët e veta. Sot Zafir Berisha le të bëjë koalicion me ta, në ardhje qekz Shukri Quni, qe, as nuk më intereson se unë jam në opozitë. Unë i thashë atje po unë shoh që ai djalë si nuk ëh PDK-ja po e merr. Thashë po e marrë këtë shoh që po e marrin drejtë e drejtë. Se kam atë punë me atë punë. Vazhdo kryesues.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** A ka dikush tjetër? Që nuk ka, e hedhim në votim pra që t'ia rekomandojmë mbledhjes së Kuvendit këtë pikë. Sa jemi për. 6 për. 2 Kundër. Pra miratohet kjo pikë që t'ia rekomandohet Kuvendit për mbledhjen e ardhshme.

#### **6. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Kalojmë te pika e gjashtë. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026. Këtu paraprakisht pra ne para se ta sjellim në Kuvend këtë material kemi mbajtur takime me përfaqësuesit e partive politike dhe ata të cilët janë zgjedhur në Kuvend me votat e tyre për planin e punës së Kuvendit. Po ashtu edhe me shefat e grupeve. Materialin e kemi të gjithë para vetes që ka dikush me shtu rreth planit të punës të Kuvendit. Urdhëroni.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Urdhno Dafinë?

**Dafina Alishani:** Propozoj me fut zyrën e personelit me e raportu në Kuvend. Gjithmonë e kemi pas një.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** është aty.

**Dafina Alishani:** A është? Se mu më është thënë që nuk është.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Po po është. Në korrik apo në qershor është? Qershor është. E di që është kjo pikë e rendit të ditës. Është kërkue. A ka dikush tjetër? A është kjo pikë e rendit të ditës?

**Shukri Quni:** A raportojnë kta Hidroregjioni për ujë? Nuk na ka ardhur hiq sa je kan ti në mandat.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Ka ardhur ai, por u ndërper seanca, ishte seanca e fundit më duket me sa e di unë aty që edhe nuk ka raportuar.

**Shukri Quni:** Tani tash mirë vazhdo.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Tani kush mundet me qysh e shihni të arsyeshme cilin muaj ju mendoni që ta fusim me raportimin e Hidroregjonit?

**Shukri Quni:** Në korrik duhet me e fut me e raportu. Se sot ska nevoj me raportu. Në korrik kur nuk ka ta kqyrim.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Në Kuvend, në Kuvend atëherë. E lajmë në Kuvend këto propozimet. I marrim të gjitha këto propozimet edhe votohen në Kuvend.

**Shukri Quni:** Po edhe hynë në seancë. Kqyrim. Këtu si i ndamë ne aty në seancën e kaluar ne e thashë. Këtu si i ndamë ne aty ka tre, tre milionë e kusur euro për ta. Ai duhet me ardhë ktu me i raportu. Se unë e di që ajo kompani është s'ka lidhje me ne. Po paret me i marrë po, a punën me e krye jo . Ai vjen e raporton zotëria pse nuk po, edhe me KEC-sin edhe ata duhet me ardhur me na raportuar. Nuk kanë ardhur aty për një hanë këtu, po janë, janë edhe secila qeveri që udhëheq Kosovën e ka në kontroll edhe KEC-in edhe Hidroregjonin e Prizrenit. Ne duhet të kërkojmë llogari prej tyre. Mos të bëhemi krejt ose be, ose shkojmë krejt nshpi. Nuk jam duke kërkuar unë diçka që tha Agnesa po bën politikë, nuk është politik kjo, se unë vuj për ujë. S'kam ujë. A krejt, krejt e furnizojnë Hasin me me ujë të pijshëm Nashec. Nuk kemi ujë. Edhe le ta kryejnë punën si ka hije. Edhe a e di qysh? Ti s'ke pas kontakt me ta. Me e bërë me shkuar ata në zyrë atje, ata taman sillen në atë, në atë stilin e e diktatorëve, domethënë që ne jemi këtu. Këta policinë e kanë dashur me i thirrur ata. Thotë do të të çoj në zyrë do të të thërras policinë. Thashë jo policinë po thirre kanë dush se nuk qohna pa e kry. Qeshtu është puna se jemi ardhur me mbrojt të drejtat e qytetarëve? Na duhet me raportue edhe Keds-in le të vijë ai zotëria drejtori. Se kur po i shkoj atje në protestë para para shtëpisë aty, as nuk po është në gjendje me dalë e me fol. Ne e kemi protestuar rrafsh shtatë ditë në fshatrat që s'kemi pas rrymë muajin më të nxehtë në gusht. Ata duhet dikujt me e dhënë përgjegjisi se aj paret po i merr.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** E përcjellim në Kuvend, i propozon atë ditë pikat edhe i fusim i votojmë në Kuvend.

**Shukri Quni:** Mos harrofsha, përkujtoma.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Ta përkujtojmë edhe këtë. Ka dikush tjetër që nuk ka atë edhe në votim që t'ia rekomandojmë Kuvendit këtë pikë rendi të ditës. Kush është për? 9 pra janë për, unanimitisht kjo pikë i rekomandohet Kuvendit.

#### **7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale KRM "Eko-Regjioni" Sh.A. Prizren;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Vazhdojmë me pikën e shtatë. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale Eko

Regjioni, shoqëria aksionare Prizren. Fjalën e ka drejtori për këtë pikë të rendit të ditës. Zoti Islam, urdhëroni.

**Islam Ukimeri:** Zoti kryetar, faleminderit. Siç e dini edhe ju që çdo mandat aksionar i ndërmarrjeve publike për të ndërmarrë në përfundimin e mandatit që është në asamble, për të hyrë ka përfunduar dhe tash obligohemi që të formojmë edhe aksionarë të rinj në mandat të ri. Andaj kemi këtë kështu që pika e shtatë e rendit të ditës e ka të bëjë me Eko Regjionin dhe me këtë ndërmarrje aksionare që janë dy, dy ndërmarrjet tona. Po. Dy ndërmarrjet tona. Edhe obligohemi që të formojmë komision. Janë dy anëtarë që formohen nga asambleja dhe janë për propozim nga kryetari.

**Agnesa Sinanaj Gavazaj:** Cila është formula?

**Shukri Quni:** Formula PDK shkon edhe VV e ti je tu ja majt veq zhagin.

**Islam Ukimeri:** Jo nuk e di formulën.

**Haziz Hodaj:** Jo s'ka edhe VV, pse në PDK edhe VV ?

**Shukri Quni:** Po këta dy shkojmë pse?

**Haziz Hodaj:** Jo nuk ka, nuk ka aty. Aty zgjidhen me votë, zgjidhen me votë.

**Islam Ukimeri:** Unë në mandatin e kaluar kam qenë aksionar në ndërmarrjen e aksionare të autobusëve. Kanë qenë dy, kanë qenë një prej PDK-së edhe dy prej këtij grupi domethënë të PDK-së dhe se një ka qenë i Vetëvendosjes. Kemi kaluar jashtëzakonisht mirë po të them të drejtën. S'po e shoh pse duhet me e bërë këtë me bërë atë dhe opozitën gjithë këtë problem. Po aty vendos asambleja, nuk vendos.

**Haziz Hodaj:** Jo jo aty shkon, aty shkon një prej nesh edhe një prej, prej jush partnerët e koalicionit edhe kaq. Ata që i kanë votat ata i zgjedhin. Jo jo jo po ajo.

**Shukri Quni:** Po unë e kam pas kurrfarë interesi hiq. A e di që po reagoj në mënyrë që të dalë. Ky po e bën njëherë tak te pika e tij sikur domethënë...

**Haziz Hodaj:** Qysh po e pas interesin? Pse po fol, pse po fol ti?

**Shukri Quni:** S'kam interes personal.

**Haziz Hodaj:** Po as unë s'kam personal.

**Shukri Quni:** Jo ke personal se përnjëherë thotë partisë tonë domethënë e ke këtë. Po jo a po nuk është personal ai? Ka qenë personal. Nuk ka, është personal.

**Shukri Quni:** Partisë s'ja thash emrin. S'të thashë unë mos e merr ti partinë.

**Haziz Hodaj:** Jo jo po ti a personal është për vete ja unë jam duke folur për në emër të subjektit, në subjektin që e përfaqësoj. Ne jemi ne jemi në koalicion. Edhe po kërkoj që ne me pas një, një kandidat, kaq.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Sot kështu jemi.

**Haziz Hodaj:** Përndryshe ajo del në votë, fitohet me votë domethënë edhe edhe..

**Simir Krasniqi (Kryesues):** E sot kështu jemi. Sotë jemi të rekomandojmë Kuvendit.

**Haziz Hodaj:** Po pse Albin Kurtit i bëni 20 ministra nuk i bëni asnjë të opozitës?

**Dafina Alishani:** Kush?

**Haziz Hodaj:** Albini. Kryeministri.

**Dafina Alishani:** A ban veq pak, se jeni tu e përzi, a ban me e nda shapin prej sheqerit. Qysh a po don ministër me bë prej opozitës? Kjo është komision.

**Haziz Hodaj:** Po edhe komisioni e bën, e bën opozitën.

**Dafina Alishani:** Po komisioni çfarë, veç pak, komisioni çfarë roli ka?

**Haziz Hodaj:** Ka rol mbikëqyrës. Nuk e di unë çfarë roli ka.

**Dafina Alishani:** Ka rol mbikëqyrës. Qysh po don me bë rol mbikëqyrës pa pas opozitë? A po doni veç ju mes vete?

**Haziz Hodaj:** E keni ju pozitën nga e cila e mbikëqyrni. Nuk e, nuk e kemi problem me atë punë Dafin. Zgjidhen me votë. Bëhet propozimi, zgjidhen me votë. Kaq.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Edhe edhe..

**Haziz Hodaj:** Në momentin që zgjidhen me votë, dihet kush fiton, ai që ka numrat. Që s'po lejohet të flasim.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Po, faleminderit baca Haziz. Kjo është, ne nuk kemi nevojë këtu për emra. Emrat jepen në Kuvend, votohen, është vota ajo e cila e determinon se kush ëh..

**Haziz Hodaj:** Jo jo ne duhet me e ditë, duhet me e ditë se duhet me e pas seancën, do të kemi takime do të kemi takime.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Paraprakisht para seancës ju duhet me i mbajt takimet, edhe emrat sillen në seancë.

**Haziz Hodaj:** Kështu që ju s'keni nevojë me u lodh për atë punë për me e gjetë. Lena neve. Na jemi këtu.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Fjalën e ka drejtori zotri Isalmi.

**Islam Ukimeri:**Në qoftë se lejohet shkurt se ju i keni emrat edhe me bërë një shkurt.

**Dafina Alishani:** Ndoshta ti i ke në mendje e po të doket që i kena folë.

**Islam Ukimeri:** Propozimi bahet per me dal në votim, me u votu dy kandidatë prej asambleës dhe i qon nenkryetari, edhe sa i përket mu kanë në opozitë domethanë nëse na sipas procedurave aksionari e formon bordin, bordi zgjedh kryeshefën ekzekutiv e ndërmarrjes, atëher kryeshefi i raporton bordit edhe aksionaret i raportojnë kryetarit dhe asambleistëve. Adin është nifar një arkiv se raportimi që bëhet sa i përket raporteve dhe procedurave janë, na duhet me marrë asambleist njëher për këto, nuk kemi me i raportu ndërmarrjes.Nuk domethanë emra të përveqëm se nuk është me rëndësi kush, se ato i zgjedh asambleja nuk është e percaktume pozita ose opozita është cili i ka numrat.Na edhe herën e kalume i kena pas, sa për informat të shkurtë se spo du me ba shumë debat. Na o kan propozu LDK-ja, marrëveshje LDK-ja dhe Vetvendosja e kan pru Adem Shabanin ka qenë ne votim aksionar prej ndërmarrjes. Kërkesën o kan LDK-ja kta janë marr vesh mes veti e kanë pru,bani marrëveshje apat po bani në asamble jo ktu, a po kupton. Kush vjen për neve,kush votohet është në rregull.Si drejtori na e kemi propozu me u kan aksionar edhe tash kush vjen aty nuk e di cila parti vjen ajo është qështje e asambleës.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Falemiderit.

**Islam Ukimeri:** Edhe niher nëse më lejohet shkurt kryesues?

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Po, po mundesh shkurt.

**Islam Ukimeri:** E njejta është e njejta temë është aty te stacioni i autobusavene dhe ekoregjionit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Edhe te ekoregjioni njejt është e njejta mos ta përsërisim dy herë. Atëhere po e hedhim në votim pra pikën e 7. Kush është që ti rekomandohet Kuvendit? Gjashtë për. Kundër? 3 kundër. Mirë pra pika e 7 i rekomandohet Kuvendit.

**Shukri Quni:** Propozim vendimin nuk e pranoj në disa pika ne të cilat shkojnë vetëm interesat. Kaniher duhet me u kqyr për me shku edhe me funksionu Kuvendi si duhet o djem se keni me pa, keni vakt ju ajt se ju te rijt keni me u msu që keni mu qudit.

**Arianit Berisha:** Jepne naj kandidat të mirë edhe na ndrroni menden.

**Shukri Quni:** Qka u bë.

**Arianit Berisha:** Naj kandidat të mirë,aty qe kontribon në komision nashta.

**Shukri Quni:** Edhe me ja u pru ju se votoni.Ju mu kanë të mirë i paraqitni dy të PDK-se edhe LDK-së sja qoni asnja hiq.

**Haziz Hodaj:** S'osht problem.

**Shukri Quni:** Paraqitni ju dy të PDK-së unë kam me i votu.

**Haziz Hodaj:** Po ti i ki tre vota e na i kemi gjashtë qaty osht problemi, se sun mrrinu ju me kta.

**8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A – Prizren;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Mirë kalojm, kalojm te pika e tetë. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit per formimin e grupit të komisionit komunal të aksionarve të ndërmarrjeve publike, lokale, stacioni i autobusave pra, kjo ishte ekoregjioni. Pika e shtatë, ju ma shum e moret fjalën per stacionin ,kur janë pika të njëjta atëhere nuk ka. E hedhim në votim pikën e tetë. Po, kush është për që ti rekomandohet Kuvendit, rendit të ditës. 6 për. Kundër? Ska. Abstenim? Nuk ka. Pika e 8 i rekomandohet Kuvendit.

**9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit dhe iniciimin e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të tij;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Pika e nëntë, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për themelimin e kshillit për trashëgimi kulturore të qendrës historike të Prizrenit, dhe iniciimin e procedurave për zgjedhjen e antarëve të tij. Ktu pra, paraprakisht kemi mbajt takim me shefat e grupeve parlamentare. Ne pra ja rekomandojmë Kuvendit, vetëm iniciimin pra të procedurave, hapjes së ftesës publike për kshillin për trashëgimi kulturore. Vendimin e kini, materialin e keni para vetes që këni dikush që don me shtu diqka urdhëroni .

**Haziz Hodaj :** Kemi emra domethanë.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Jo nuk ka emra, vetëm ktu për me , shpalljen publike të ftesës publike për kshillin për trashëgimi kulturore.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit. Atëherë kët pikë e hedhim në votim që t’ja rekomandojmë kuvendit Kush është për? Unanimisht pra 9 antarë të KPF-së votuan për.

**10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit ad hoc për organizimin e procesit të zgjedhjes së tre (3) anëtarëve të Këshillit të Fshatit Zym i Hasit;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Kalojmë në pikën e nëntë e dhjetë. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit ad hoc për organizimin e procesit të zgjedhjes së

tre anëtarëve të Këshillit të fshatit Zym. Këtu pra i zgjedhim pesë anëtarë, pra votohen nga Kuvendi për themelimin e tre e Këshillit të fshatit Zym që këta do t'i bëjnë ftesën publike edhe për zgjedhjen pra të tre anëtarëve këtu. Arberi mundet me na dhënë sqarim pra Arberi, në qoftë se keni.

**Arber Krasniqi:** Përshëndetje të nderuar. Kjo është një pikë e rendit të ditës që Kuvendi, mbas ligjit për fshatin Zym, Kuvendi e organizon zgjedhjen e anëtarëve të fshatit të Zym i Hasit. Pra është si kjo do të ka me u bë një vendim, ka me u themelu komisioni prej Kuvendit. anëtarët e Kuvendit e kanë mbajtur një takim shëfat e grupeve, kanë propozuar që pesë anëtarë prej Kuvendit që e kanë me shkuar në fshatin Zym e kanë me bë thirrje publike, organizimin e zgjedhjes atje tani, kanë me e prurë tre emrat në Kuvend për votim. Kjo nisje e procedurave. Tjetër diçka s'ka këtu.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** A ka dikush këtu rreth këshillit të fshatit Zym? Baci Haziz? A ka dikush me shtu këtu që nuk ka atëherë.

**Haziz Hodaj:** Veç ju duhet me i tregu skemën për me këtu qysh, qysh këta anëtarë të komisionit qysh zgjidhen prej cilës, cilëve subjekte?

**Arbër Krasniqi:** Prej të gjithëve.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Prej të gjithëve. Prej kush kush të propozon pesë e shkojnë.

**Shukri Quni:** Domethënë pesë anëtarë.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Pesë anëtarë.

**Haziz Hodaj:** Këta janë, këta janë për zgjedhje. I përzgjedhim tre anëtarë të Zymit, fshatit atje, e monitorojnë zgjedhjen, këta e organizojnë zgjedhjen e qysh i Emrat e tyre atje. E mandej ata dy të tjerët, ata mbas zgjedhjes të tre atje, zgjidhen në Kuvend.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Mandej vjen vendimi edhe dy zgjidhen prej Kuvendit. Atëherë e hedhim në votim që këtë pikë t'ia rekomandojmë Kuvendit.

**Shukri Quni:** Ti s'shkon atje.

**Dafina Alishani:** Pse mos me shku, qka ka lidhje.

**Haziz Hodaj:** Qka ka lidhje që jam deputet. Qe a pe sheh që e votove, qysh e votove a e harrove? Po e votove pra atëherë.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Unanimisht dhe kjo pikë i rekomandohet Kuvendit.

**Shukri Quni:** Atë ditë jemi marr vesh, a jemi marrë Dafinë? Që ky komision mu formua.

**Dafina Alishani:** Po, A edhe diçka se komisionet ad hoc, a kanë të drejtë anëtarët e KPF-së me qenë pjesë?

**Arber Krasniqi:** Po mundeni. Ad hoc po. Po anëtarët e KPF-së edhe anëtarët e komiteteve të tjera nuk kanë të drejtë vetëm në komitetet që quhen. Këto udhezimi administrativ ja ndalon. Për shembull anëtarë të KPF-së nuk kanë..

**Dafina Alishani:** Aty shkrun komisione të tjera. E tash s'isha e sigurt a është komitete të tjera. Komitete a komisione?

**Arber Krasniqi:** Komitete. Komitete të tjera se ne jemi tu fol për komitete. Po komitete të tjera.

**Shukri Quni:** Po na takojka neve të Hasit me shku.

**Haziz Hodaj:** A po pse a po s'ka pak të Hasit a? Ka dhënë Zoti shyqyr plot.

**Agnesa Sinanaj Gavazaj:** Tash merrnu vesh ju Hasjantë mes veti, na s'ja u prishim. Ka edhe tjerë aty që janë Hasjan.

## **11. Shqyrtimi dhe miratimi i draft planit të punës të veprimit të transparencës 2026-2030;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Kalojmë pra në pikën e 11. Shqyrtimi dhe miratimi i draft planit të punës të veprimit të transparencës 2026-2030. Ne e kemi zyrtarin këtu për transparencë. Mund ta marr fjalën. Urdhëroni zotri Ymer.

**Ymer:** Me qenë në fillim të mandatit do të kishim pas më shumë angazhime ëh, dokumenti derivon prej rregullores së transparencës që është miratuar vitin e kaluar. ëh, jo pa qëllim e kemi lënë se besoj ishte vit zgjedhor. E lamë të paktën planin prurjet e reja në Kuvend. Të jetë socializuar edhe të njoftuar se çfarë do të ndodhë komuna sa i përket transparencës dhe llogaridhënies së përgjegjshmërisë 2026-2030 që ta kemi fjalën ligjore dhe për këtë arsye jemi në këtë punë. Në këtë vit e kemi edhe një dokument për pjesën e dytë të këtij viti që është strategjia për publikun dhe e kemi edhe një dokument që e plotëson ëh, vizionin e transparencës, llogaridhënies së këtij institucioni të komunës. Plani i veprimit parasheh në mënyrë të detajuar përgjegjësitë e kryetarit të komunës, me qenë që është i zgjedhur drejtpërdrejtë me ligj për vetëqeverisjen lokale të jetë me kompetenca të mëdha të vendimmarrjes. Vendimmarrja e tij duhet të jetë e hapur dhe e njohur për publikun. Dhe ky plan e ka brenda këtë kërkesë në raport me kryetarin. Po ashtu plani i veprimit për transparencë e ka organin e dytë, Kuvendin ku bëni pjesë edhe ju. Detyrime ligjore kemi edhe ju pak më shumë se kryetari. Çdo vendim duhet të jetë i hapur për të gjithë qytetarët e komunës së Prizrenit. Përrjashtim nëse eventualisht ndonjë vendim domethënë klasifikohet. Ju merrni vendim të klasifikoni. Në rastet janë për shembull për elementet e terrorizmit ose elemente të naturave që qojnë sinjale destabilizuese te qytetarët. Përndryshe komuna e Prizrenit, nëse heqim pak modestinë, normalisht ka ndërtuar kapacitete relativisht të mëdha në këtë fushë dhe tash e udhëheqim për sa i përket cilësisë, nivelin e Kosovës. Kështu që jemi dy nga tre komuna që jemi më të shquara edhe Eko Regjioni ëh, të zyrave ose komunave të Kosovës në këtë fushë. Edhe një informatë tjetër, unë tash kohët e fundit pak edhe në Ministrinë e punësimt të Pushtetit Lokal e

kam ngarkuar atje një departament të Enver Krasniqit që quhet digjitalizim dhe jemi duke punuar edhe me Qeverinë e Kosovës. Në këtë rast unë jam veç ekspert i jashtëm nga komuna. Se shumë shërbime ne gjatë këtyre viteve deri në 2030 mendohet që shumë shërbime që i kemi marrë fizikisht do të kalojnë në platformat që Qeveria e Kosovës, shteti ynë tash do të ndërtojë platforma që qytetarët e ruajnë kohën, e ruajnë paratë. Sikurse është e-Kosova, e-Komuna, tash shkojmë edhe me disa aplikime. Janë duke u punuar për shembull edhe në sektorin e prokurimit, edhe në sektorin e rekrutimit që të ketë platforma vetëm me numra edhe të hiqen emrat. Me me me e ngushtuar sa është e mundur që të ndikimin politik që ne e quajmë ta zëmë se po ndikon vendimmarrëse ose e tjera e tjera. Por kjo varet prej Qeverisë. Unë i jap ekspertizën atje dhe i jap modelin e komunës së Prizrenit sa sa është e mundur. Plani i veprimtimit për transparencë normalisht e ka atë. Përputhjen ligjore e keni të plotë. Madje neve ka viti 2028 ka mundësi që të diskutojmë pak edhe për inteligjencën artificiale. Por meqë ligji në Kosovë akoma nuk e ka paraparë se si mund të rregullohet kjo. Por po ta jap si ide, si vizion i komunës së Prizrenit që e kam këtë drejtimin, jemi duke e menduar që edhe intelijenca artificiale të futet për ta ndihmuar vendimmarrjen e komunës dhe për ta bërë për llogari jo të kryetarit, jo të Kuvendit, por për llogari të qytetarëve, audiencia publike,<sup>24</sup>.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Mirë faleminderit zoti Ymer. Urdhëroni në qoftë se ka pyetje dikush? Atëherë këtë pikë ja rekomandojmë kuvendit kush është, e hedhim në votim. Kush është për? Të gjithë pra 9 anëtarët e KPF-së janë që kjo pikë ti rekomandohet kuvendit.

## **12. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës janar-dhjetor 2025;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Vazhdojmë me pikën e 12 raporti i punës së kryetarit të komunës janar dhjetor 2025. Si çdo vit pra edhe këtë vit pra kryetari raporton para, para kuvendarëve raportin pra do ta dëgjoni të gjithë ne e rekomandojmë kuvendit këtë pikë. Që ka dikush me shtu diçka urdhëroni, që nuk ka e hedhim në votim që t'ja rekomandojmë kuvendit.

**Haziz Hodaj:** S'kemi qka me shtu na, kur të na jep raportin diskutojmë.

**Dafina Alishani:** Atëher masi që është fillimit mos ta ta kemi këto si KPF-së mandatin e kaluar ne kemi pas këtë si domethënë respektim edhe edhe e kisha të hapur si diskutim që secila pikë që vjen në KPF prezantuesi ose sponsorizuesi duhet me qenë prezent në mbledhje në mënyrë që me pas në rend dite. Tash më herët ne kemi pas gjithmonë për raportim qoftë nënkryetari kryetari kur s'ka qenë prezent a mundeni vetëm me na siguru që prezenca e kryetarit ka me qenë raportim se ka pas tendenca gjithmonë me ja dhënë dikujna tjetër raportimin edhe pikat kur të vijmë në KPF duhet me qenë secili sponsorizues domethënë nuk ka më me me propozu pika edhe mos me qenë personi i cili ka me diskutu, ta kemi këto prej fillimit si rregull edhe ekzekutivi besoj e shpresoj që mundet me respektu këtë gjë.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** E sheh tash është mbledhja e dytë e KPF-së Dafinë edhe përveq kryetarit që është prezent nënkryetari e din që është zgjedhur deputet atje edhe kryetari në këtë moment mund të ketë ndonjë takim tjetër edhe mos të jetë prezent por në kuvend do të jetë aty edhe do të raportojë para të gjithë kuvendarëve. Atëherë e hedhim në votim. Po urdhëro Shukri.

**Shukri Quni:** Ti e din që unë shumë herë e kam kritikuar komitetin për politikë dhe financa pikërisht për e përdorsha një fjalë që nuk e di çka domethënë kjo fjalë me hedhë e kam përdorur këtë fjalë se thonë që komiteti për politikë dhe financa osht me hedhë rendin e ditës, nga rendi i ditës edhe shkon e çon në kuvend krejt kjo është se çka kemi me diskutu. Na me tanë këto pika se në fillim s'kishim në këtë rend me i thonë këto pika tash që i votum po tash votën e keni i bëni veç të mos shkojnë zbatim se raporti i punës edhe janë disa i auditorit këto duhet në kuvend thonë në fund pra njësi mësimore në klasë kur ta man ti vetë një profesor ka fundin edhe nxënësit i bën bajat do të thotë kur bëhet një seancë natyrore gjërat më kryesore duhet me u qitë në pikën e tretë e katërt që mund të diskutohet e këto që janë këto këto kanë vlerat e veta por këto që nuk kanë shumë diçka rëndësi të madhe këto edhe me i lënë në fund të rendit të ditës unë nuk e shoh këtë që si kryesues tash unë tash në rendin e ditës ti e di që janë me i lënë këto në fund të gjitha po është mirë me përmbajtje veten herë se kur të kap ky inati aty zbutohesh edhe ti shumë sende e di që e kështu që mbroji kaniherë të drejtat.

**Haziz Hodaj:** Vërejtja, vërejtja është me me me vend domethënë sa i përket tash se ne kemi pas raporte deri në fund të mandatit shumë kemi pas raporte por le të jetë për për hera tjetër a sugjerim që raportet se nuk është raporti financiar raporti i kryetarit të jenë në fokus më të madh po masi jemi këtu hala se u kthjem prap te rendi i ditës unë e pata një propozim po kërkoj edhe mirëkuptimin. Kemi hapësira mjaft për për me diskutu në pika të rendit të ditës ta hekim gjitha pyetje e përgjigje bile në këtë seancë për këtë seancë.

**Dafina Alishani:** A e din qfar reagime ke pas ti në mandatin e kaluar, a di qysh ke thënë ti mos po na ndalni zënin ju neve kuvendarëve tash.

**Haziz Hodaj:** Po tash oj qikë, unë e pata e thashë kemi, i kemi, i kemi, i kemi shumë pika të rendit të ditës ku muj me diskutu edhe muj me e shprazë krejt arsenalin politik e gjithçka për qat për qat punë.

**Dafina Alishani:** Qka kemi na punë tjetër si kuvendar, çka kemi punë.

**Haziz Hodaj:** Për qat punë thashë për me e shkurtu, për me e shkurtu qato me po e hekim pyetje dhe përgjigje për këtë seancë se për me e shti qeto pyetje e përgjigje unë e kam shti në fillim kur është bërë pika e rendit të ditës ka ardhur prej meje propozimi.

**Dafina Alishani:** Mirë e qka po met për opozitën.

**Haziz Hodaj:** A ka degradu në skajshmëri që ka nevojë me e hek kjo tash i pari isha qenë që e kisha hek.

**Dafina Alishani:** Po masi je në pushtet.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** E kemi fut në plan të punës të kuvendit...

**Haziz Hodaj:** e kam thënë edhe vitin e kaluar edhe e kam thënë edhe mandatin e kaluar..

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Po duhet ta diskutojmë që këtë pikë shumica e komunale e kanë fund këtë se gjithë energjia po është po shpenzohet te ajo pikë edhe nuk po kemi kohë me i dëgju pikat raportet e drejtorëve dhe të gjithë këtë, a po kjo po nuk na ndodh ëh pata thënë se thashë pse ka ndodh prej korrikut nuk ka pas seanca edhe janë grumbullu pikat edhe janë afatet ligjore që duhet me i kry këtë muaj këta.

**Dafina Alishani:** çka ka fat ligjor, më fal raporti i performancës për vitin 2024 paska ardhur në 2026-ën që shtyhet një muaj kurrgjë s'ka problem.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Urdhëro Aziz.

**Haziz Krasniqi:** Pika 13, 14, 15 dhe 16 lidhen me sistem të performancës po sistemi aktual i performancës për vitin 2024 është hapur në zyrën e njësisë së qendrore që do të nuk ka dalë domethënë unë e kam komuna e Prizrenit merr minus pikë në këto fusha edhe në disa prej indikatorëve të tjerë të cilët janë të lidhur me sistemin.

**Dafina Alishani:** Mirë seanca a zgjatë dy ditë, ditën e dytë nuk e kemi pas po supozojmë nuk ka me pas kourum edhe nuk ka me u mbajt, çka bëhet?

**Haziz Krasniqi:** Unë çka bëhet.

**Dafina Alishani:** Po supozojmë.

**Haziz Hodaj:** Po se supozime ka gjithmonë, supozimet gjithmonë ekzistojnë, supozimet ka edhe nesër mundet me me me u munguar jo veç mbas nesër.

**Haziz Krasniqi:** Kjo pika 13, 14, 15 dhe 16 në vitin në vazhdim nuk kanë pas në fund.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Mirë e hedhim në votim, a don me marrë fjalën?

**Ymrane Fusha:** Se unë e desha këtu te diskutimet kërkesat e asamblesë së kuvendarëve unë e të gjitha kërkesat e mia tani i kam marrë metodë të re edhe po bëj kërkesë nëpër drejtorinë e komunës së Prizrenit edhe po postojmë mandej në rrjetet sociale kështu që mos me e marrë mos me e humb kohën.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Mirë, faleminderit.

**Shukri Quni:** Sa kërkesa i baj unë ata si marrin parasysh ata drejtorët e tu hiç.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** E hedhim në votim pikën e dymbëdhjetë, t'ia rekomandojmë Kuvendit, kush është për ,raporti i punës kryetarit janar dhjetor 2025.

**Haziz Hodaj:** A s'jeni për me e dhënë, për me e dhënë raportin a.

**Shukri Quni:** Unë kam qef kryetari me ja nis i pari, jo more votat i keni s'ka problem.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** E hedhim në votim për raportin e punës kryetarit të komunës janar dhjetor 2025. Kush është për? 8 për. 1 një. Atëherë pika 12 i rekomandohet Kuvendit.

### **13. Raporti financiar vjetor janar-dhjetor 2025;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Raporti financiar vjetor janar dhjetor 2025 e kemi drejtorin këtu të financave apo zyrtarin e financave që të raportojë për raportin mundësisht më shkurt se ky raport do të shkojë.

**Levent Bus:** Pasi nesër e kemi seancën.

**Haziz Hodaj:** Hajde po e kryejmë sot ta kryejmë sot bile mos lodhemi se nesër kemi me u marrë turrë.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** A pajtoheni të gjithë që atëherë erdhëm në votim pikën e 13.

**Agnesa Sinanaj Gavazaj:** Baci Shukri?

**Shukri Quni:** Për çka pajtohem, jo kjo patjetër kjo ka me u diskutu.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** E hedhim në votim edhe njëherë mundësisht që pikën e 13 raporti financiar vjetor financiar vjetor janar dhjetor 2025. Kush është për? Unanimisht pra me 9 vota i rekomandohet kuvendit pika 13.

### **14. Diskutim rreth raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prizrenit për vitin 2024 dhe planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2024;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Pika e 14 diskutimi rreth raportit të zyrës kombëtare të auditimit dhe për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Prizrenit për vitin 2024 dhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2024.

**Dafina Alishani:** Po zyra auditorit?

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Urdhëroni zyra auditorit, kush është drejtori i financave kush merr fjalën. A doni?

**Dafina Alishani:** Jo zyra e auditorit s'jeni ju.

**Lulzim Sulejmani:** Raportin financiar, raportin financiar nënshkruhet dhe auditori nuk ka nevojë me qenë këtu.

**Dafina Alishani:** Diskutim rreth raportit të zyrës kombtare të auditimit.

**Lulzim Sulejmani:** Aj është i brendshëm, ky është raporti i auditimit të jashtëm.

**Shukri Quni:** Na e kemi diskutu në asamble.

**Haziz Hodaj:** Po e kemi diskutu të brendshmin, po ky është i jashtëm.

**Lulzim Sulejmani:** Ky është i ZKA-së.

**Shukri Quni:** Kujna me ju drejtu na me këto?

**Haziz Hodaj:** Qeverisë me ju drejtu, zyrave kombtare.

**Shukri Quni:** Kqyre une jam kanë vet kur e kum pasë pushtetin, unë jam kanë qaty ku je kan ti në pushtet . Kto lojna i din edhe ma mirë se une domethanë je kanë para meje. Na kur dojshim me lodhë Kuvendin pikat ma të rëndësishme që u duke me i diskutu i lishim ne fund. Ti vet je qu edhe ke kundërshtu njëqind herë.

**Haziz Hodaj:** Po bre po.

**Shukri Quni:** Po qka po e mbron ti?

**Haziz Hodaj:** Po s'jam tu e mbrojtë, unë po të thamë për qet raport tash është i zyrës kombëtare të auditimit. Edhe ata ti kanë ba...

**Shukri Quni:** Pikën e tretë duhet me e diskutu o Haziz .

**Haziz Hodaj:** Po s'osht në pikën e tret tash, qka me bo?

**Shukri Quni:** Po s'oshtë po duhet me e qitë.

**Haziz Hodaj:** E qesim herën tjetër.

**Shukri Quni:** Pse se ngrite dorën me thanë , hiqe qet pikë?

**Haziz Hodaj:** Tash e ki raportin rreth qatij raporti diskotojmë na.

**Shukri Quni:** Po mirë bre Haziz Hoda, Ramadan Muja kur ish qetu thojke ma në zorë jam prej teje se sa prej opozitës. I thojsha o profesorë unë jam tu të kritikimi me hecë përpara mirë, se une me ta ba ty se unë e di ti si kta ti PDK-në me e gjujtë në humnerë ti qat qef e ki.

**Haziz Hodaj:** Jo more jo.

**Shukri Quni:** Qysh jo?

**Haziz Hodaj:** Jo në humnerë s'kam qef as ni parti me e qu, se janë pasuni kombëtare.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Mos të dalim prej temës, e hedhim në votim...

**Shukri Quni:** Jo mos u gut, kadal-kadale, nuk është vetëm me folë veq kur je në pozitë, nuk është mirë, na nuk jemi drejtor. Une ti e din shumë mirë Mytahir Haskukes i thojsha unë jam sikur ti i zgjedhur mos kujto ti që i hek drejtorat na hek edhe neve, na jemi të barabartë me vota, ty t'kemi zgjedhe na na ta kemi dhanë votën, e tash qajo vota jonë të shkarkon apert me deshtë, edhe une e kam kta që na me shku edhe me funksionu si ka hije ky Kuvend se sa për qysh ka shku pot kallxoj katastrofë është.

**Lulzim Sylejmani:** Kryesues nëse më lejohet pak.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Po urdhëro, Lulzim.

**Lulzim Sylejmani:** Pika e 14 i atribohet pasqyrave financiare të auditimit që e ka ba auditori i jashtëm, auditimi i brendshëm është qe e ban n'kët rast Agroni nëse keni kërkesa në të ardhmen me qet raport të tina. Kjo është për pasqyrat financiare të cilen e diskutojmë dhe e mbrojmë edhe ju përgjigjem pyetjeve që keni domethanë drejtorja e financave. Konkretisht domethanë ZKF-ja.

**Shukri Quni:** Na u keqkuptum pak, se une thash që qekjo pikë mu kan.

**Lulzim Sylejmani:** Krejt në rregull është.

**Shukri Quni:** Qaty mashum e pata, se këto kanë me u diskutu.

**Dafina Alishani:** Kush raporton në qet pikë , më fal?

**Lulzim Sylejmani:** Drejtori dhe ZKF-ja. Se ZKF-ja është nënshkrues i pasqyrave financiare.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Mirë e hedhim në votim këtë pikë që të ja rekomandojmë Kuvendit, pikën e 14. Kush është për? 8 për. Kundër? 1. Atëherë kjo pikë e 14 i rekomandohet kuvendit për mbledhjen e ardhshme.

## **15. Informatë rreth raportit për planin e Integritetit për vitin 2025;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Pika e 15 informatë rreth raportit për planin e integritetit për vitin 2025 kemi përfaqësuesen këtu mundësh me marrë fjalën.

**Emine Gashi:** Fillimisht ky raport rrjedh prej planit të integritetit raporti bëhet çdo gjashtë muaj në agjencinë për parandalimin e korrupsionit realisht 21 fusha të rrezikut janë përfunduar me sukses në prej gjithë komunës së Prizrenit 27 janë pjesërisht realizu ne kurse dy pa realizu ne informatë tjetër përveç raportit është se komuna jonë ka arritë me e përditësu planin për vitin 2026 gjë që agjencia për parandalimin e korrupsionit e ka konfirmu që është në rregull dhe e kemi me vazhdu me planin e ri përditësu prej komunës së Prizrenit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Mirë faleminderit, don dikush fjalën?

**Haziz Hodaj:** Shkojmë në kuvend.

**Simir Krasniqi (Kryesues):**E hedhim pikën e 15 në votim. Unanimisht pra kjo pikë i rekomandohet kuvendit.

#### **16. Informatë rreth raportit të performancës për Komunën e Prizrenit për vitin 2024.**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Pika 16 informatë rreth raportit të performancës për komunën e Prizrenit për vitin 2024 i kemi përfaqësuesin apo iniciuesin e pikës, fjala për ju Haziz.

**Haziz Krasniqi:** Faleminderit unë edhe unë do të jem shumë i shkurtër për raportin në fushën e performancës edhe mund me e qitë në faqe të publiku në faqen e komunës të gjithë anëtarët e performancës aktualisht sistemi i performancës është i hapur edhe zyrtarët për gjithë seancën për vitin 2025 po e kam raportin për 2024 ëh sistemi i performancës i ka 16 fusha ëh në sistemin e performancës i kam përmendur edhe fushat ku kemi rënie edhe ku kemi ngritje edhe unë kam bërë një analizë ëh vitit 2023 sa kemi pas në përqindje edhe dallimet me 2024 prej ëh në sistemin e performancës e nisim me fushën e parë që është shërbimet publike administrative në 2023-ën kemi qenë në votë të 8% ndërsa vitin 2024-ën në 100% ëh këtu i kam bërë edhe dallimet se ku ka pas rënie ku ka pas rritje trasparenca komunale fillon me 91% që ka qenë në 2023-ën tash është 100% ëh përgjegjshmëria komunale që është njëra prej fushave më të mëdhaja që e kemi shtinë edhe kuvendin kryesisht kuvendin edhe një pjesë të financave ka qenë 76% ka ardhur në 2024-ën në 78% besoj që këtë vit kemi qenë pak më mirë këtë vit këtë vit këtë vit ëh kemi obligim që deri më 28 në shkurt çdo katër pika 13 14 15 dhe 16 me u diskutuar në kuvend ndërsa unë me dalë unë këtë radhë komuna me dalë mirë në ëh performancë për vitin 2025 shërbimet publike në qendër të shërbimeve sociale ka qenë 55% në në 2023-ën tash është 58 ëh kostot e sportit ka qenë në 49 tash është 86 ëh mbrojtja e mjedisit ka qenë 100% ku kemi një rënie prej 50% dhe shkollimi që plani për angazhimin emergjent ëh është miratu në vitin 2025 të tona të kemi nisur deri në 2024-ën mund të kemi marrë provat edhe realisht kështu është ndërsa tash ne duhet me dalë në 100% në ato fusha e lehtësim i fatkeqësive në një kemi arritur ka qenë 100% ëh në të dy vitet ëh hapësira publike ëh

ka rritje në vitin 2024-ën ëh ju flas për katër fusha edhe këtu ka unë kam një dallim shumë të madhe transporti publik edhe kjo nuk është kështu që ka një rëndësi të madhe shërbimet publike kanë qenë 34% tash janë 100% ëh mbrojtja e mjedisit ka qenë 33% tash është 57% ëh barazia gjinore ka qenë 37 në 2023-ën ëh 76 është në 2024-ën arsimiti parauniversitar ka qenë 80 në 2023-ën 86 është në 2024-ën kujdesi për arsimin primar dhe sekondar ka qenë 72 ëh tash është 79 kemi bërë përpjekje këtë vit se kemi bërë përpjekje këtë vit që me e rritë ëh përqindjen tek fusha e shëndetësisë edhe zhvillimi ekonomik lokal ka qenë 86 ëh tash është ëh ka qenë 86 në 2023-ën është 84 në 2024-ën ëh na ka munguar një dokument aty e kemi bërë përpjekje që ta shtimë dorën për vitin 2025-ën ëh besoj që kemi me pas përqindje. Kaq kam unë tash nëse keni diçka unë jam këtu.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit, ka dikush që don me marrë fjalën?

**Shukri Quni:** Unë e desha se tash kur e diskutojmë këtë gjë mirë ëh unë e pak më si kjo rruga mbas të qkafit do të bëhet performanca. Në qka jeni bazu që e keni bë performanën. Te mjedisi tash përshembull.

**Haziz Krasniqi:** Unë jam i caktuar prej kryetarit me vendim dhe shërbimet publike sistemi i performancës ministria e mjedisit dhe pushtetit lokal dhe donatorët ëh kanë hartuar një sistem elektronik ky sistem elektronik ëh futen të dhënat e institucioneve përgjegjëse, ëh komuna e Prizrenit i ka 30 drejtorë përgjegjës përfshirë edhe unë si koordinator secili e ka fushën e vet edhe në atë fushë i i ngarkon dokumentat të cilët ëh drejtoria ose apo njësia i i posedon edhe në rastet kur ëh nuk i posedon ëh mban shënim që në vitin tjetër ne me me e bërë domethënë kjo është sistem elektronik domethënë komuna i shtin të dhënat pastaj me MAPL-në i verifikon edhe e kthen raportin në final.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Dikush tjetër, atëherë pikën e 16 e hedhim në votim që ti rekomandohet kuvendit. Unanimisht pra kjo pikë u votu edhe i rekomandohet kuvendit. Ju faleminderit për pjesëmarrje takohemi në seancën e nesërme në orën 10:00.



Kryesuesi i KPE-së  
Simir Krasniqi